

Në përputhje me autorizimin e dhënë në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, si dhe nenin 25, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2014 miratoi:

Rregullore mbi Statistikat e Instrumenteve të Pagesave

Neni 1 Qëllimi

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për arritjen e objektivave të saj, përpilon dhe publikon Statistikat e Instrumenteve të Pagesave. Qëllimi i Rregullores mbi Statistikat e Instrumenteve të Pagesave (në tekstin e mëtejme —Rregullorja) është raportimi i Statistikave mbi Instrumentet e Pagesave. Rrjedhimisht, Rregullorja definon statistikave që duhet të raportohen, raportuesit dhe obligimet statistikore të raportuesve, periudhën e raportimit, raportet statistikore, si dhe konfidencialitetin.

Neni 2 Përkufizimet

Për qëllim të kësaj Rregulloreje:

- “BQK” – Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
- “SIP” – Statistikat e Instrumenteve të Pagesave.
- “Instrument i pagesave elektronike” (IPE) është instrumenti që i mundëson mbajtësit të kryejë pagesa elektronike. Këtu përfshihen si instrumentet e pagesave me qasje në distancë, ashtu edhe instrumentet e parasë elektronike.
- “Instrument i pagesave në letër” janë urdhërpagesa të urdhëruara nga ana e klientit në formë letre (urdhërtransfer, urdhërpagesë, etj)
- “Pagesë elektronike” është transaksioni i pagesës, i realizuar nëpërmjet një karteletë që përmban një shirit magnetik, një mikro chip ose një kod identifikues dhe që përdoret në një terminal të pagesave elektronike, në një terminal pikë shitje (anglisht: POS) etj. apo nëpërmjet një aplikacioni të bankës duke përdorur mjete elektronike të komunikimit.
- “Pagesa në para të gatshme” janë transaksionet që kryhen në para të gatshme në sportelet e bankës (qoftë deponim apo tërheqje).
- “Debitimi direkt” është instrument i pagesës me të cilin klienti autorizon bankën përmes kompanisë të debitojë (tërheqë) mjete drejtpërdrejt nga llogaria bankare.

— “Kartela bankare” është instrumenti i pagesës elektronike, i lëshuar nga një bankë e licencuar për të kryer transaksione bankare me funksione të caktuara paraprakisht.

— “Phone/mobile banking” është një shërbim që lejon mbajtësin të përdorë telefonin për të realizuar transaksione të ndryshme bankare, përfshirë mundësinë për të bërë urdhërpagesa nga një llogari bankare.

— “E-banking” është një shërbim, që lejon mbajtësin të realizojë transaksione të ndryshme bankare, përfshirë urdhërpagesat duke përdorur internetin.

— “Llogari bankare” do të thotë çdo llogari e hapur në një bankë në bazë të një kontrate të lidhur ndërmjet një klienti dhe bankës, qoftë ajo llogari rrjedhëse ose llogari tjetër dhe përfshin një llogari sipas një marrëdhënie të veçantë, të krijuar vetëm për qëllim të realizimit të një urdhërpagese.

— “Transaksione brenda vendit” nënkupton transfertën e fondeve nga urdhëruesi te përfituesi, edhe urdhëruesi, edhe përfituesi i kanë llogaritë në bankat brenda Kosovës.

— “Transaksione ndërkombëtare” nënkupton transfertën e fondeve nga urdhëruesi te përfituesi në dy banka të veçanta ku njëra prej tyre vepron në vend dhe është e licencuar nga BQK-ja, kurse tjetra në një shtet tjetër.

Neni 3

Raportuesit

Bankat komerciale në mënyrë periodike raportojnë në BQK raportet e caktuara statistikore. Në pajtim me nenin 25, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, raportues janë të gjitha bankat komerciale.

BQK-ja në raste të caktuara specifike, mund të kërkojë nga bankat komerciale raporte statistikore shtesë bazuar në mostrën dhe format e përcaktuara paraprakisht. BQK-ja i informon me shkrim dhe nëse është e nevojshme i kontakton subjektet, që janë të përfshira në mostër për mënyrën në të cilën duhet të bëhet raportimi.

Neni 4

Obligimet statistikore të raportuesve

Raportuesit janë të obliguar që t’i ofrojnë informatat që i kërkon BQK-ja me qëllim të përpilimit të SIP-ve në nivel të Kosovës. Informatat e kërkuara statistikore duhet të jenë të gatshme për BQK-në në formatet e dërguara nga BQK-ja. BQK-ja në parim përcakton subjektet individuale si njësi raportuese.

Për të gjithë raportuesit që nuk i përmbushin kërkesat statistikore të parapara me këtë Rregullore, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës do të veprojë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 5 Periudha e raportimit

Raportet statistikore duhet të dërgohen në BQK në periudha të rregullta, sipas afateve të paraqitura më poshtë:

<u>Raportet</u>	<u>Afati i raportimit</u>
• Raportet ditore	t+1 (1 ditë pas periudhës referuese)
• Raportet mujore për rezervën e obliguar	t+5 (5 ditë pas periudhës referuese)
• Raportet mujore për instrumentet e pagesave	t+15 (15 ditë pas periudhës referuese)

Raporti vjetor i bankave komerciale përfshin përmbledhje të raporteve mujore. Nëse statistikatat përfundimtare nuk janë në dispozicion brenda këtyre afateve, të dhënat e përkohshme (preliminare) duhet të dorëzohen në BQK, brenda afatit të përcaktuar me këtë Rregullore. Çdo rishikim (revidim) i statistikave nga ana e raportuesve duhet të raportohet përsëri në BQK, në momentin kur identifikohet ai.

Neni 6 Raportet statistikore

Bankat komerciale raportojnë në BQK në baza të rregullta periodike dhe në përputhje me afatet siç është specifikuar në nenin 5 të kësaj Rregulloreje. BQK përmes *Metodologjisë për Raportim të Instrumenteve të Pagesave*, e cila është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje definon në mënyrë të detajuar raportet statistikore që dorëzohen në BQK. Udhëzimet për raportim përmbajnë format e detajuara për raportim dhe instruksionet mbi plotësimin e këtyre formave. Raportet statistikore që dorëzohen në BQK janë:

- Raportet ditore
 1. *Forma 1-A Raporti mbi paranë e gatshme në arkë të bankave komerciale (50%), për monitorim të rezervës së obliguar;*
- Raportet mujore për rezervën e obliguar
 2. *Forma 2-A. Raporti i depozitave të bankave për monitorim të rezervës së obliguar¹*
- Raportet mujore për instrumentet e pagesave
 3. *Forma 13-A. Numri i kartelave, terminaleve dhe llogarive në vend;*
 4. *Forma 13-B. Transaksionet sipas instrumentit të pagesës;*

¹ Të dhënat mbi paranë e gatshme (50% e parasë së gatshme) dhe depozitave të bankave janë të raportuara drejtpërdrejt nga bankat komerciale në sistemin "SEKN" të BQK-së në baza ditore (paraja e gatshme) dhe mujore (depozitat). Raportet statistikore, neni 6. Forma 1. A dhe 2.A

5. *Forma 13-C. Transaksionet sipas tipave të terminaleve;*
6. *Forma 13-D. Transaksione sipas vendit;*
7. *Forma 13-E. Transaksione cash në arkë/sportel.*
8. *Forma 13-F. Numri i terminaleve ATM dhe POS sipas qyteteve*
9. *Forma 13-G. Statistika mbi mbajtësit e kartelave*
10. *Forma 13-H. Numri i kartelave aktive*
11. *Forma 13-I. Pagesat e-banking*

Neni 7 **Konfidencialiteti**

Në pajtim me legjislacionin në fuqi, BQK-ja respekton konfidencialitetin në lidhje me të dhënat individuale, që dërgohen nga raportuesit, si dhe i përdorë ato të dhëna vetëm për qëllime statistikore, siç është përcaktuar në këtë Rregullore.

Neni 8 **Kualiteti i informatave të raportuara**

Me qëllim të ngritjes së vazhdueshme të kualitetit të statistikave të raportuara, BQK-ja bën monitorimin dhe vlerësimin e kualitetit të të dhënave të dërguara në BQK dhe ndërmerr të gjitha masat, që i konsideron të arsyeshme dhe të nevojshme për t'u siguruar që cilësia e të dhënave të jetë në bazë të standardeve statistikore të përcaktuara.

Neni 9 **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja mbi Statistikat e Instrumenteve të Pagesave, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, më datë 24 nëntor 2011.

Neni 10 **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Bedri Peci

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës



METODOLOGJIA "PËR RAPORTIMIN E INSTRUMENTEVE TË PAGESAVE"

I. HYRJE

Bazuar në Ligjin për Sistem të Pagesave, neni 8, si dhe në Rregulloren mbi Statistikat e Instrumenteve të Pagesave dhe me qëllim të përmbushjes së funksionit të saj publik si mbikëqyrëse e sistemeve të pagesave, Banka Qendrore e Kosovës ka hartuar këtë dokument mbi metodologjinë e raportimit të instrumenteve të pagesave, që pjesëmarrësit e sistemeve të pagesave duhet ta përmbushin. Kjo metodologji synon ndërtimin e një baze të dhënash mbi përdorimin e instrumenteve të pagesave në funksion të objektivave të cekura më lartë.

Struktura e metodologjisë është ndërtuar sipas llojeve të instrumenteve të pagesave, tipat e transaksioneve dhe llojet e terminaleve ku instrumentet e pagesave përdoren. Metodologjia është hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të përcaktuara nga Banka Qendrore Evropiane (BQE) dhe Banka Ndërkombëtare për Shlyerje (BIS).

Raportimi i bërë sipas standardeve të parapara në këtë dokument do t'i mundësojë BQK-së të:

- a) Monitorojë zhvillimet në sistemin e pagesave,
- b) Monitorojë përdorimin e instrumenteve të pagesave,
- c) Monitorojë rreziqet që lindin nga këto sisteme, dhe të
- d) Rritë transparencën mbi raportimin e instrumenteve dhe sistemeve të pagesave.

Këto të dhëna do të ndihmojnë në krijimin e politikave të ndryshme që do të ndihmojnë BQK-në në përmbushjen e detyrave dhe qëllimeve të saj.

Në mënyrë të hollësishme metodologjia përfshin:

- a) Format për raportim;
- b) Sqarimin e procedurave për raportim;
- c) Instruksionet mbi hartimin e raporteve; dhe
- d) Shpjegimin e termeve.

FORMAT PËR RAPORTIM

Format e bashkëngjitura që janë pjesë e këtij raporti janë:

Forma 13-A. *Numri i kartelave, terminaleve dhe llogarive*

Forma 13-B. *Transaksionet sipas instrumentit të pagesës*

Forma 13-C. *Transaksionet sipas tipave të terminaleve*

Forma 13-D. *Transaksione sipas vendit*

Forma 13-E. *Transaksione cash në arkë/sportel*

Forma 13-F. *Numri i terminaleve ATM dhe POS sipas qyteteve*

Forma 13-G. *Statistika mbi mbajtësit e kartelave*

Forma 13-H. *Numri i kartelave aktive*

Forma 13-I. *Pagesat e-banking*

PROCEDURAT PËR RAPORTIM

Subjektet që raportojnë janë të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga BQK-ja.

Periodiciteti dhe afati i raportimit është si më poshtë:

- Format raportohen në periudha mujore. Afati i fundit i raportimit është jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të çdo muaji.
- Ndryshime të tjera mund t'i bëhen këtij dokumenti sa herë, që shihet e nevojshme për të reflektuar ndryshime të pritshme në fushën e veprimit.
- BQK-ja ka të drejtën që në çdo kohë të kërkojë informata shtesë apo raporte ad-hoc nga subjektet që merren me shërbime pagese.
- Raportimi bëhet në Departamentin e Sistemeve të Pagesave, përkatësisht në Divizionin për Mbikëqyrje dhe Analiza të Sistemit të Pagesave. Dërgimi i raportit bëhet përmes:
 - postës elektronike (raporti i bashkëngjitur) në këtë adresë: payment.systems@bqk-kos.org,
- Njësia monetare e raportimit është EUR (€). Raportimi bëhet i veçantë për secilën valutë si: USD (\$), CHF, GBP e tjera. Konvertimi në EUR bëhet sipas kursit zyrtar të përcaktuar nga Banka Qendrore në ditën e fundit të periudhës raportuese.
- Banka Qendrore publikon të dhënat e raportuara nga bankat në mënyrë të agreguar.
- Bankat raportojnë në përputhje me afatet dhe formën e përcaktuar në këtë metodologji. Në rast të mosrespektimit të kësaj metodologjie, BQK-ja merr masa të parashikuara në kuadrin ligjor dhe rregullativ.

II. INSTRUKSIONE MBI HARTIMIN E RAPORTEVE

Forma 13 - A. Numri i kartelave, terminaleve dhe llogarive

Forma 13 – A përbëhet nga tri (3) tabela: **Numri i kartelave, numri i terminaleve dhe numri i llogarive**. Tabela *Numri i kartelave* përbëhet nga 4 (katër) pikë. Për secilën pikë dhe nënpikë duhet të raportohet numri i kartelave, të lëshuara nga banka raportuese, sipas tipit dhe numri total i kartelave (në kolonën e fundit), të cilat janë të vlefshme/aktive gjatë periudhës së raportimit. Këtu përfshihen edhe kartelat e lëshuara nga banka raportuese në bashkëpunim me kompanitë, nëse ka të tilla. Kartelat mund të jenë: kartela lokale, VISA, MasterCard dhe kartela të tjera. Nëse një kartelë ofron më shumë se një funksion, ajo duhet raportuar në secilën prej pikave/nënpikave (I, II.1 dhe II.2) sipas funksioneve që mbart. Në numrin total të kartelave (pika IV), çdo kartelë raportohet vetëm një here, pavarësisht funksioneve që mbart.

- I. **Kartela me funksion cash-i** – Në këtë pikë raportohet numri i kartelave që i japin mundësi klientit të depozitojë ose të tërheqë cash nga një terminal (ATM).
- II. **Kartela me funksion pagese** – Në këtë pikë raportohet numri i kartelave që i japin mundësi klientit të kryejë pagesa. Këto kartela janë: kartelat me funksion debiti me funksion krediti dhe kartelat me funksion debitimi të vonuar.
 - a. Kartela me funksion debiti – Raportohet numri i të gjitha kartelave me funksion debiti, përfshirë kartelat me funksion debiti të vonuar.
 - b. Kartela me funksion krediti – Raportohet numri i të gjitha kartelave me funksion krediti.
 - c. Kartela me funksion para elektronike - Në këtë pikë raportohet numri i kartelave, që ruajnë në vete vlera monetare në formë të parasë elektronike. Këto kartela mund të jenë për një përdorim ose me mundësi rimbushjeje. Në nënpikën (III.1) raportohet numri i kartelave me funksion para elektronike të cilat janë mbushur së paku një herë gjatë periudhës së raportimit.
- III. **Numri total i kartelave** – Në këtë pikë raportohet numri total i kartelave të lëshuara klientëve nga banka raportuese, që janë të vlefshme gjatë periudhës së raportimit, pavarësisht funksioneve që mbartin. Në nënpikën (IV.1) raportohet vetëm numri i kartelave që kanë funksion të kombinuar debiti, krediti, cash-i apo para elektronike.

Tabela *Numri i terminaleve* përbëhet nga 4 (katër) pikë. Për secilën pikë dhe nënpikë duhet të raportohet numri i terminaleve në pronësi të bankës raportuese gjatë periudhës për të cilën raportohet. Në këtë tabelë përfshihen të gjitha tipat e terminaleve: ATM, POS, virtual POS dhe terminale për përdorimin e parasë elektronike. Nëse terminali i bankës ofron më shumë se një funksion, atëherë ai raportohet në secilën nënpikë sipas funksionit të tij (I.1, I.2 dhe I.3) apo (II.1 dhe II.2). Kurse në pikat e tabelës, ku raportohen numri total i terminaleve (I, II, III, dhe IV), çdo terminal raportohet vetëm një herë, pavarësisht funksioneve që mbart.

- I. **Automated Teller Machines (ATM)** – Në këtë pikë raportohet numri total i ATM-ve në pronësi të bankës raportuese gjatë periudhës raportuese.

1. ATM me funksion tërheqje cash – Raportohet numri i terminaleve ATM që u ofrojnë mbajtësve të kartelave tërheqjen e parave cash.
 2. ATM me funksion transferim krediti – Raportohet numri i terminaleve ATM që u ofrojnë mbajtësve të kartelave të ekzekutojnë urdhër transfera nga llogaria bankare e tyre.
 3. ATM me funksion depozitim cash - Raportohet numri i terminaleve ATM që u ofrojnë mbajtësve të kartelave të kryejnë depozita.
- II. Terminale POS (Point of Sale)** - Në këtë pikë raportohet numri i përgjithshëm i terminaleve POS në pronësi të bankës raportuese gjatë periudhës raportuese. Këto terminale iu mundësojnë klientëve që kanë kartela me funksion pagese të kryejnë pagesa elektronike pranë pikave të shitjes.
1. Terminale POS me funksion tërheqje cash– Raportohet numri i terminaleve POS, që u ofrojnë mbajtësve të kartelave jo vetëm kryerjen e pagesave nëpër pikat e shitjes, por edhe tërheqjen e cash-it.
 2. Terminale EFTPOS - Raportohet numri i terminaleve POS, që u ofrojnë mbajtësve të kartelave vetëm kryerjen e pagesave nëpër pika të shitjes.
- III. Terminale virtuale POS për përdorimin e kartelave** - Në këtë pikë raportohet numri total i terminaleve virtual POS në pronësi të bankës raportuese gjatë periudhës raportuese. Këto terminale iu mundësojnë klientëve që kanë kartela me funksion pagese të kryejnë pagesa elektronike për blerje në internet.
- IV. Terminale për përdorimin e parasë elektronike** - Në këtë pikë raportohet numri total i terminaleve që lejojnë përdorimin e parasë elektronike. Këto terminale iu mundësojnë klientëve të kryejnë pagesa me para elektronike, apo të rimbushin kartelat e tyre.

Tabela *Numri i llogarive* përbëhet nga 1 (një) pikë e vetme. Për këtë pikë dhe për secilën nënpikë duhet të raportohet numri i llogarive të klientëve pranë bankës raportuese gjatë periudhës për të cilën raportohet të ndara sipas valutës së llogarisë në EUR, USD, CHF, GBP dhe “valuta të tjera”.

Në pikën I (një) raportohet numri total i llogarive të klientëve në bankën raportuese. Në nënpika raportohet numri i llogarive të rezidentëve (individuale dhe afariste) dhe numri i llogarive të jorezidentëve (individuale dhe afariste). Po ashtu, në këtë tabelë në kolonat vijuese raportohet veçmas për numrin e llogarive që përdorin E-banking, numrin e llogarive që përdorin Debitimin Direkt dhe numrin e llogarive që përdorin urdhëresën periodike.

Forma 13 - B. Transaksionet sipas instrumentit të pagesës

Forma 13 – B përbëhet nga 6 (gjashtë) pikë. Për secilën pikë dhe nënpikë duhet të raportohet numri dhe vlera e pagesave sipas instrumentit të përdorur për të kryer pagesa brenda dhe/ose jashtë vendit.

Në këtë formë raportohen të gjitha pagesat të iniciuara nga subjekti, i cili mund të jetë urdhëruesi apo përfituesi i fondeve. Pagesa konsiderohen transferimet e fondeve në mes të subjekteve të ndryshme (apo në mes të të njëjtit subjekt). Subjekt (tutje Klient) mund të jenë: klientët e bankës raportuese apo vet banka raportuese. Banka raportuese konsiderohet si klient që shlyen detyrimet e veta dhe mund të jetë urdhërues apo përfitues i fondeve.

Numri i urdhërpagesave, si njësi numerike, konsiderohet totali i debitimeve në llogari. Një instruksion pagese gjithmonë numërohet vetëm një herë. Raportimi bëhet i ndarë sipas valutave në EUR, USD, CHF, GBP dhe “valuta të tjera”.

I. Transfere kreditimi të iniciuara nga klientët - Në këtë pikë raportohen kredit transferet e iniciuara nga klienti, të ndara sipas mënyrës së dërgimit të urdhërpagesës, në formë letër apo në formë joleter. Këtu përfshihen edhe transferet e kreditit të kryera nëpërmjet një ATM-i, pagesat periodike, etj. Xhiro pagesat individuale gjithmonë raportohen si një transaksion.

a. Transfere krediti në formë letër – Raportohen vetëm kredit transferet të urdhëruara nga klienti në formë letër. Këtu raportohen edhe kredit transferet elektronike që kërkojnë procesim manual nga punonjësit e bankës për t’u ekzekutuar, si për shembull urdhërpagesat përmes telefonit.

i. përmes cash-it – Raportohen kredit transferet në formë letër në të cilat udhëzuesi kryen pagesën përmes cash-it.

1. Xhiro Pagesa - Në këtë pikë raportohen pagesat që kryhen përmes xhiros në të cilat udhëzuesi kryen pagesën përmes cash-it.

a. pagesat INTRA (brenda bankës) - Raportohen vetëm xhiro pagesat në të cilat udhëzuesi, që kryen pagesën përmes cash-it dhe përfitues janë klientë të bankës raportuese.

b. pagesat INTER (ndërbankare) - Raportohen vetëm xhiro pagesat përmes cash-it, në të cilat vetëm udhëzuesi (debitori) i pagesës është klientë i bankës raportuese.

2. Transfere të tjera - Në këtë pikë raportohen kredit transferet tjera në formë letër të paguara në cash.

ii. përmes llogarive – Raportohen kredit transferet në formë letër në të cilat udhëzuesi kryen pagesën përmes llogarisë bankare.

1. Xhiro Pagesa - Në këtë pikë raportohen pagesat që kryhen përmes xhiros në të cilat udhëzuesi kryen pagesën përmes llogarisë bankare.

a. pagesat INTRA (brenda bankës) - Raportohen vetëm xhiro pagesat në të cilat udhëzuesi, që kryen pagesën përmes llogarisë bankare dhe përfituesi janë klientë të bankës raportuese.

b. pagesat INTER (ndërbankare) - Raportohen vetëm xhiro pagesat përmes llogarisë bankare, në të cilat vetëm

udhëzuesi (debitori) i pagesës është klientë i bankës raportuese.

2. Transaksione periodike ("standing order") – Në këtë nënpikë raportohen pagesat periodike që kryhen në mes të llogarive të bankës dhe klientit, sipas marrëveshjes/kontratës së nënshkruar nga palët. Pagesa periodike konsiderohen shlyerjet e kësteve të kredive, primet e sigurimit, qiraja, kontrata për mirëmbajtje, etj. Në rastin e ekzistencës së shumë përfituesve kundrejt një paguesi, numërimi bëhet duke konsideruar numrin e përfituesve.

3. Transfere të tjera - Në këtë pikë raportohen kredit transferet tjera në formë letër të paguara nëpërmjet llogarive bankare.

b. **Transfere krediti në formë jo-letër** – Raportohen vetëm kredit transferet të urdhëruara nga klienti në formë elektronike dhe që nuk kërkojnë ndërhyrje manuale të punonjësve të bankës për t'u ekzekutuar.

a. **E-banking** – Kredit transferet elektronike përmes internetit.

b. **Mobile banking** - Kredit transferet elektronike përmes telefonit.

c. **ATM** – Kredit transferet elektronike përmes ATM-ve.

d. **Të Tjera (specifiko)** – Kredit transferet elektronike në forma të tjera.

II. **Pagesa të iniciuara nga klientët me kartela** – Në këtë pikë raportohen pagesat që kryhen nga klienti përmes kartelës së lëshuar nga banka raportuese. Këto pagesa kryhen me kartela të bankës raportuese në terminale (POS apo ATM) brenda dhe jashtë vendit. Terminalet mund të jenë të bankës raportuese apo të bankave të tjera. Këtu po ashtu raportohen edhe pagesat e kryera nëpërmjet internetit, telefonit apo formave të tjera, me anë të një karteletë të lëshuar nga banka raportuese. Pagesat e kryera me anë të kartelave të lëshuara nga bankat tjera përmes terminaleve të bankës raportuese, nuk raportohen pasi ato raportohen nga banka respektive që ka lëshuar kartelën.

a. Pagesat me kartela me funksion debiti – Raportohen vetëm pagesat me kartela me funksion debiti, përfshirë kartelat me funksion debiti të vonuar.

b. Pagesat me kartela me funksion krediti – Raportohen vetëm pagesat me kartela me funksion krediti.

III. **Direkt Debit** – Në këtë pikë raportohen pagesat që kryhen në zbatim të ndonjë marrëveshjeje "direkt debiti." Pagesat raportohen nga banka e përfituesit. Për direkt debitet pagesa individuale gjithmonë raportohen si një transaksion.

a. Pagesat INTRA (brenda bankës) – Raportohen vetëm pagesat Direkt Debit në të cilat edhe udhëzuesi (debitori) edhe përfituesi (kreditori) janë klientë të bankës raportuese.

b. Pagesat INTER (ndërbankare) – Raportohen vetëm pagesat Direkt Debit në të cilat vetëm përfituesi (kreditori) është klient i bankës raportuese.

- IV. **Pagesa me para elektronike** – Në këtë pikë raportohen pagesat me para elektronike, të iniciuara nga urdhëruesi (klienti me para elektronike) në favor të përfituesit.
 - a. Pagesat me para elektronike përmes një karteje – Raportohen vetëm pagesat me para elektronike në formë karteje.
 - b. Pagesat me para elektronike të tjera - Raportohen pagesat me para elektronike jokartelë.
- V. **Pagesa me instrumente të tjera (specifiko)** – Në këtë pikë raportohen pagesat e klientëve me instrumente të tjera, që ofron banka raportuese dhe nuk përfshihen në asnjë nga pikat e përmendura më lart.
- VI. **Totali i pagesave të klientëve (prej I deri V)** – Në këtë pikë raportohet shuma e pagesave të raportuara në pikat I deri V.

Forma 13 - C. Transaksionet sipas tipave të terminaleve

Forma 13 – C përbëhet nga 6 (gjashtë) pikë. Për secilën pikë dhe nënpikë duhet të raportohet numri dhe vlera e transaksioneve. Në këtë formë raportohen transaksionet e iniciuara të klientëve sipas terminalit dhe kartelës së përdorur. Pikat raportuese të këtij aneksi janë:

- I. Transaksione në терминаlet e instaluar nga banka raportuese, me kartela të lëshuara nga banka raportuese.
- II. Transaksione në терминаlet e instaluar në vend nga bankat tjera, me kartela të lëshuara nga banka raportuese.
- III. Transaksione në терминаlet e instaluar jashtë vendit, me kartela të lëshuara nga banka raportuese.
- IV. Transaksione në терминаlet e instaluar nga banka raportuese, me kartela të lëshuara nga banka të vendit.
- V. Transaksione në терминаlet e instaluar nga banka raportuese, me kartela të lëshuara nga banka jashtë vendit.
- VI. Numri total i transaksioneve në терминаlet e bankës raportuese (I + IV +V).

Për secilën nga pikat e mësipërme raportohen nënpikat e mëposhtme. Pavarësisht valutës së urdhërimit të transaksionit, transaksionet raportohen vetëm në EUR. Në rast të transaksioneve në valuta të tjera, konvertimi i tyre në EUR bëhet sipas kursit zyrtar të përcaktuar nga banka raportuese në ditën e fundit të periudhës raportuese.

- 1. ATM tërheqje cash
- 2. ATM depozitime
- 3. Kredit transfere nëpërmjet ATM-ve
- 4. Tërheqje cash në terminale POS
- 5. Pagesa me kartela në terminale POS

Forma 13 - D. Transaksione sipas vendit

Forma 13 – D përbëhet nga 3 (tre) pikë. Për secilën pikë dhe nënpikë duhet të raportohet numri dhe vlera e transaksioneve. Transferet individuale gjithmonë raportohen si një

transaksion. Raportimi bëhet i ndarë sipas valutave në EUR, USD, CHF, GBP dhe “valuta të tjera”.

- I. **Transaksione brenda bankës** - Në këtë pikë raportohen të gjitha transaksionet e bankës raportuese brenda saj përmes cash-it dhe llogarive të klientëve.
 1. Përmes llogarive – Raportohen vetëm transaksionet brenda bankës raportuese të cilat kryhen përmes llogarive të klientëve. Në këto transaksione edhe udhëzuesi (debitori) edhe përfituesi (kreditori) janë klientë dhe kanë llogari te banka raportuese.
 2. Përmes cash-it – Raportohen vetëm transaksionet brenda bankës raportuese të cilat kryhen përmes cash-it. Në këto transaksione udhëzuesi paguan me cash dhe përfituesi (kreditori) është klientë dhe ka llogari në bankën raportuese.
- II. **Transaksione ndërbankare** - Në këtë pikë raportohen të gjitha transaksionet hyrëse dhe dalëse ndërbankare të bankës raportuese. Këto janë transaksionet e bankës raportuese me bankat e tjera të vendit.
 - a. Pagesat hyrëse ndërbankare – Raportohen vetëm transaksionet hyrëse ndërbankare ku banka raportuese apo klienti i saj janë përfitues (kreditor).
 - b. Pagesat dalëse ndërbankare – Raportohen të gjitha transaksionet dalëse ndërbankare, përmes cash-it dhe llogarive, ku banka raportuese apo klienti i saj janë udhëzues (debitor).
 - i. përmes llogarive– Pagesat dalëse ndërbankare të bankës raportuese përmes llogarive.
 - ii. përmes cash-it – Pagesat dalëse ndërbankare të bankës raportuese përmes cash-it.
- III. **Transaksione ndërkombëtare** - Në këtë pikë raportohen të gjitha transaksionet hyrëse dhe dalëse ndërkombëtare të bankës raportuese.
 - a. Pagesat hyrëse ndërkombëtare - Raportohen vetëm transaksionet hyrëse ndërkombëtare ku banka raportuese apo klienti i saj janë përfitues (kreditor).
 - b. Pagesat dalëse ndërkombëtare - Raportohen të gjitha transaksionet dalëse ndërkombëtare, përmes cash-it dhe llogarive, ku banka raportuese apo klienti i saj janë udhëzues (debitor).
 - i. përmes llogarive - Pagesat dalëse ndërkombëtare të bankës raportuese përmes llogarive.
 - ii. përmes cash-it – Pagesat dalëse ndërkombëtare të bankës raportuese përmes cash-it.

Forma 13 - E. Transaksione cash në arkë/sportel

Forma 13 – E përbëhet nga 1 (një) pikë dhe 2 (dy) nënpika. Për secilën pikë dhe nënpikë duhet të raportohet numri dhe vlera e transaksioneve. Raportimi bëhet i ndarë sipas valutës: EUR, USD, CHF, GBP dhe valuta të tjera.

- I. **Transaksione në arkë** - Në këtë pikë raportohen transaksionet cash të klientëve të bankës raportuese pranë sporteleve (arkave) të saj dhe mund të jenë depozitime ose tërheqje në cash.

- a. Depozitime cash në arkë - Raportohen vetëm transaksionet cash në arkë, në të cilat klienti i bankës raportuese depoziton cash në llogarinë e tij.
- b. Tërheqje cash në arkë – Raportohen vetëm transaksionet cash në arkë, në të cilat klienti i bankës raportuese tërheqë cash nga llogaria e tij.

Forma 13 - F. Numri i terminaleve ATM dhe POS sipas qyteteve

Forma 13-E përbëhet nga dy pika: I- Terminalet ATM (aktiv dhe pasiv) dhe II- Terminalet POS (aktiv dhe pasiv). Këtu raportohen terminalet ATM dhe POS të shpërndara nëpër tërë komunat e Kosovës.

- I. Terminalet ATM aktiv- në këtë pikë raportohen terminalet ATM të cilat janë përdorur për të kryer së paku një transaksion gjatë periudhës raportuese.
- II. Terminalet ATM pasiv- në këtë pikë raportohen terminalet ATM të cilët nuk janë përdorur për të kryer së paku një transaksion gjatë periudhës raportuese.
- III. Terminalet POS aktiv- në këtë pikë raportohen terminalet POS të cilat janë përdorur për të kryer së paku një transaksion gjatë periudhës raportuese.
- IV. Terminalet POS pasiv- në këtë pikë raportohen terminalet POS të cilët nuk janë përdorur për të kryer së paku një transaksion gjatë periudhës raportuese.

Forma 13 – G. Statistika për mbajtësit e kartelave

Forma 13 – G përbëhet nga një pikë në të cilën duhet të raportohen kartelat sipas gjinisë dhe moshës së mbajtësve të kartelave. Raportuesit duhet t'u përmbahen ndarjes në grup mosha të poseduesve të kartelave siç janë specifikuar në formën e raportimit.

- I. Kartelat sipas gjinisë/grup moshës së mbajtësit të kartelës-femra në këtë pikë raportohen mbajtësit e kartelave të gjinisë femërore sipas grup-moshave të paraqitura në formën e raportimit;
- II. Kartelat sipas gjinisë/grup moshës së mbajtësit të kartelës-meshkuj në këtë pikë raportohen mbajtësit e kartelave të gjinisë mashkullore sipas grup-moshave të paraqitura në formën e raportimit;

Forma 13 – H. Numri i kartelave aktive

Forma 13-H përbëhet nga tri tabela: a) në tabelën e parë raportohen kartelat që janë në posedim nga ana e klientëve; b) në tabelën e dytë raportohen vetëm kartelat që kanë qenë aktive në terminale ATM dhe POS gjatë periudhës së raportimit; dhe, c) në tabelën e tretë raportohet përqindja e kartelave aktive që përdoren në terminale të pagesave;

- I. Kartela të shpërndara- në këtë pikë raportohen kartelat në posedim të klientëve gjatë periudhës raportuese, duke përfshirë debit kartelat, kredit kartelat, kartelat me funksion paranë elektronike si dhe llojet tjera të kartelave.
- II. Kartela aktive - në këtë pikë raportohen kartelat që janë përdorur për të kryer së paku një transaksion në terminale të pagesave gjatë periudhës raportuese, duke përfshirë debit kartelat, kredit kartelat, kartelat me funksion paranë elektronike si dhe llojet tjera të kartelave.

- III. Përqindja e kartelave aktive - në këtë pikë raportohet përqindja e kartelave aktive kundrejt kartelave në posedim të klientëve, duke përfshirë debit kartelat, kredit kartelat, kartelat me funksion paranë elektronike si dhe llojet tjera të kartelave.

Forma 13 – I. Pagesat e-banking

Forma 13-1 përbëhet nga katër tabela në të cilat duhet të raportohen pagesat e kryera përmes shërbimit e-banking dhe pagesat “online” me kartela.

- I. Në tabelën e parë raportohen pagesat e kryera me e-banking si ato brenda bankës, ndërbankare po ashtu edhe ato ndërkombëtare, sipas valutave të përcaktuara në formën e raportimit.
- II. Në tabelën e dytë raportohen pagesat Kos Giro të realizuara përmes shërbimit e-banking, si për pagesat Kos Giro ndërbankare ashtu edhe ato brenda bankës.
- III. Në tabelën e tretë raportohet vlera e përgjithshme e transaksioneve të realizuara me e-banking duke përfshirë edhe ato në valuta të tjera.
- IV. Në tabelën e katërt duhet të raportohen pagesat “online” të realizuara me kartela përmes internetit.

III. TERMAT E METODOLOGJISË

Termt e mëposhtme kanë këto kuptime:

“**Bankë**” do të thotë: (i) një person juridik i cili merret me pranimin e depozitave dhe parave ose të fondeve të tjera të ripagueshme në përputhje me licencën bankare të lëshuar nga autoriteti kompetent përgjegjës për licencimin dhe mbikëqyrjen e bankave ose i themeluar me ligj si bankë; (ii) përveç bankës nga pika (a), një person juridik i autorizuar me ligj për të marrë depozita ose për të marrë pjesë në transaksionet e pagesave në llogari të klientëve dhe BQK-së.

“**Rezident**” nënkupton subjektet juridike që janë të regjistruara dhe që veprojnë në Kosovë, si dhe personat fizikë vendbanimi i të cilëve gjendet në Kosovë dhe të cilët nuk largohen nga Kosova për periudhë më të gjatë se një vit (përveç diplomatëve, studentëve dhe pacientëve mjekësor). Me fjalë të tjera, sipas definicioneve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, rezident të një vendi të caktuar janë subjektet fizike dhe juridike qendra e interesit ekonomik e të cilëve qëndron në vendin në fjalë.

“**Person juridik**” do të thotë një ndërmarrje ose një institucion publik.

“**Klient**” do të thotë një person fizik a juridik, duke përfshirë edhe një bankë e cila ka të hapur një llogari bankare.

“**Valutë e huaj**” do të thotë çfarëdo valute tjetër përveç EUR.

“**Fonde**” do të thotë para të gatshme dhe depozita që mbahen në llogari bankare.

“**Llogari bankare**” do të thotë çdo llogari e hapur në një bankë në bazë të një kontrate të lidhur ndërmjet një klienti dhe bankës, qoftë ajo llogari rrjedhëse, xhirollogari ose llogari tjetër dhe përfshin një llogari sipas një marrëdhënie të veçantë të krijuar vetëm për qëllim të realizimit të një urdhërpagese.

“**Marrëveshje**” do të thotë një kontratë ndërmjet një klienti dhe bankës e cila rregullon veprimet e llogarisë bankare, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen e saj, modifikimin dhe urdhërpagesat.

“**BQK**” do të thotë Banka Qendrore e Kosovës.

“**Urdhërpagesë**” do të thotë një urdhër i pakusht i dërguesit që i është dhënë një banke marrëse për të paguar ose për të marrë një shumë specifike të parave nga një llogari e caktuar bankare, nga i paguari ose për të paguarin, apo për llogarinë a nga llogaria e të paguarit. Kur dërguesi është një bankë, urdhërpagesa është urdhërpagesë ndërbankare.

“**Iniciator**” do të thotë dërguesi i urdhërpagesës së parë që inicion një transaksion të pagesës.

“**I paguari**” apo “**Përfituesi**” do të thotë pala që duhet të pranojë pagesën në një transaksion pagese.

“**Pagues**” apo “**Udhëzues**” do të thotë pala e cila duhet të bëjë pagesën në një transaksion pagese.

“**Transaksion i pagesës**” do të thotë transfer i fondeve nga llogaria bankare e paguesit te i paguari ose llogaria bankare e të paguarit. Paguesi dhe i paguari mund të jenë persona të njëjtë ose dy persona të ndryshëm fizikë a juridikë. Transaksioni i pagesës mund të jetë një kredi ose një transfer debiti i fondeve dhe inicohet me udhëpagesën e iniciatorit që i është dhënë bankës iniciatore, duke urdhëruar atë që ta kryejë transaksionin e pagesës. Në një transaksion pagese, llogaria bankare e paguesit mund të mbahet dhe pagesa mund t’i bëhet të paguarit qoftë në të njëjtën bankë qoftë në dy banka të ndryshme.

“**Transfer i kredisë**” do të thotë një transaksion i pagesës i kryer nga paguesi, i cili lëshon një urdhëpagesë për bankën e tij, duke udhëzuar atë që t’i transferojë fondet nga llogaria bankare e paguesit te i paguari ose në llogarinë bankare të tij. Në një transfer kredie, iniciatori është paguesi, banka iniciatore është banka e paguesit, banka destinuese është banka e të paguarit dhe marrësi është i paguari.

“**Transfer debiti**” do të thotë një transaksion i pagesës i iniciuar nga urdhëpagesa e të paguarit, sipas autorizimit të paguesit, me të cilën urdhërohet banka e paguesit për t’i tërhequr paratë nga llogaria e paguesit. Në një transfer debiti, iniciatori është i paguari, banka iniciatore është banka e të paguarit, banka destinuese është banka e paguesit dhe marrësi është paguesi.

“**Transfer brenda bankës**” do të thotë transfer i fondeve, nga udhëzuesi te përfituesi në të njëjtën bankë, përmes një urdhëpagese. Pjesëmarrës në një transfer të brendshëm janë iniciatori, banka e cila vepron si bankë iniciatore apo destinuese dhe marrësi.

“**Transfer ndërbankar**” do të thotë transfer i fondeve nga udhëzuesi te përfituesi në dy banka të veçanta që kanë, së paku dy urdhëpagesa për secilën bankë marrëse përveç bankës destinuese që kryen udhëpagesën e dërguesit të saj, duke i lëshuar urdhëpagesë përkatëse bankës marrëse, me urdhëpagesën e fundit që i është dërguar bankës destinuese. Pjesëmarrës në një transfer ndërbankar janë iniciatori, banka iniciatore, banka destinuese dhe përfituesi dhe mund të përfshijë një ose më shumë banka ndërmjetësuese. Në një transfer ndërbankar, përveç veprimit në emër të klientit, banka mund të veprojë në emër dhe për llogari të saj.

“**Transfer ndërkombëtar**” do të thotë transfer i fondeve nga udhëzuesi te përfituesi në dy banka të veçanta ku njëra prej tyre vepron në vend dhe është e licencuar në BQK, kurse tjetra në një shtet tjetër. Pjesëmarrës në një transfer ndërkombëtar janë iniciatori, banka iniciatore, banka destinuese dhe përfituesi dhe mund të përfshijë një ose më shumë banka ndërmjetësuese. Në një transfer ndërkombëtar, përveç veprimit në emër të klientit, banka mund të veprojë në emër dhe për llogari të saj.

“**Xhiro pagesat**” do të thotë pagesa e faturave nga xhirollogaritë bankare ose me para të gatshme. Përdorimi i tij kryesor është për pagesat periodike të rregullta si pagesat e faturave të shërbimeve publike, taksat ose faturat e regjistrimit.

“**Debitimi Direkt**” do të thotë transfer i debitit, ku iniciatori është i paguari, bankë iniciuese është banka e të paguarit, bankë pranuese është banka e paguesit dhe pranues është paguesi.

“**Kartelë**” do të thotë një instrument pagese elektronike i lëshuar nga një banke, që i mundëson mbajtësit të kartelës të kryejë transaksione bankare.

“**Kartelë me funksion cash-i**” do të thotë kartelë e lëshuar nga një bankë, që i mundëson mbajtësit të kartelës vetëm të tërheqë cash nga fondet e tij të disponueshme në llogarinë bankare.

“**Kartelë debiti**” do të thotë kartelë e lëshuar nga një bankë, që i mundëson mbajtësit të kartelës të kryejë pagesa dhe të tërheqë cash nga fondet e tij të disponueshme në llogarinë bankare.

“**Kartelë krediti**” do të thotë kartelë e lëshuar nga një bankë, që i mundëson mbajtësit të kartelës të përdorë një linjë krediti. Kjo kartelë i mundëson mbajtësit të kartelës të kryejë pagesa dhe të tërheq cash deri te limiti i linjës së kreditit. Linja e kreditit, koha e kthimit, etj. përcaktohen në kontratën e nënshkruar në mes të mbajtësit dhe bankës.

“**Para elektronike**” do të thotë instrument i pagesave që ruan vlera monetare në formë elektronike dhe që i mundëson mbajtësit të kryejë pagesa elektronike.

“**Home banking**” do të thotë shërbim që lejon mbajtësin të realizojë transaksione të ndryshme bankare, përfshirë urdhërpagesat, duke përdorur kompjuterin e tij me lidhje online me bankën, me anë të një linje telefonike pa përdorur internetin.

“**Phone banking**” do të thotë shërbim që lejon mbajtësin të përdorë telefonin për të realizuar transaksione të ndryshme bankare, përfshirë mundësinë për të bërë urdhërpagesa nga një llogari bankare.

“**E-banking**” do të thotë shërbim që lejon mbajtësin të realizojë transaksione të ndryshme bankare, përfshirë urdhërpagesat, duke përdorur internetin.

“**Terminal**” do të thotë pajisje që mundëson tërheqjen, depozitimin e cash-it, transferimin e fondeve, blerjen në pika të shitjes përmes kartelave etj. Lloje të terminaleve janë terminalet ATM dhe POS.

“**ATM**” (**Automated Teller Machine**) do të thotë pajisje elektromekanike e cila bën të mundur tërheqjen ose depozitimin e parasë *cash*, pagesa të shërbimeve, transferim fondesh ndërmjet llogarive, nxjerrje llogarie etj. ATM operojnë si në regjim online, ku baza e të dhënave aksesohet në kohë reale, ashtu edhe në regjim offline.

“**Terminal POS**” (**POS/EFTPOS**) do të thotë pajisje që bën të mundur përdorimin e kartave bankare në një pikë shitjeje. Informacioni për pagesën merret nëpërmjet faturave letër nga terminalet mekanike ose elektronike. Në rastin e dytë, ku njëkohësisht bëhet edhe transmetimi elektronik i informacionit, termi i referohet një “transferimi elektronik fondesh në një pikë shitjeje” **EFTPOS (Electronic Fund Transfer Point of Sale)**.

“Terminal virtual POS” (virtual POS) - është pajisja e ngjashme në shërbime me terminalin POS, e cila mundëson kryerjen e transaksioneve nëpërmjet internetit ose telefonave, me anë të kartave bankare që punojnë në regjim online.

FORMULARËT PËR RAPORTIM



Banka / Kompania:

[Redacted field]

Raportimi për periudhën:

[Redacted] / [Redacted]
tremujori viti

Përgatitur nga:

[Redacted field]

emër , mbiemër, nr telefoni

[Redacted field]

Nënshkrimi

Verifikuar nga Drejtori/Udhëheqësi:

[Redacted field]

emër , mbiemër, nr telefoni

[Redacted field]

Nënshkrimi

[Redacted field]

Data

Të gjitha fushat me ngjyrë:

- [Redacted] duhet të plotësohen
- [Blue] plotësohen automatikisht

Forma 13 - A. Numri i kartelave, terminaleve dhe llogarive në vend

Rubrika	Kartelat sipas funksionit dhe operatoreve	kartela lokale	VISA	Master Card	Tjera	Totali
I.	Kartela me funksion cash-i					
II.	Kartela me funksion pagese prej të cilave: 1 - Kartela me funksion debiti 2 - Kartela me funksion krediti					
III.	Kartela me funksion para elektronike prej të cilave: 1 - Kartelat me funksion para elektronike të cilat janë mbushur së paku një herë					
IV.	Numri total i kartelave prej të cilave: 1 - Kartela me funksion të kombinuar debiti, cash-i apo para elektronike					

Rubrika	Terminalet sipas tipit	Numër
I.	Automated Teller Machines (ATM) prej të cilave: 1 - ATM me funksion tërheqje cash 2 - ATM me funksion transferim krediti prej të cilave: a - ATM me funksion të pagesave Kos-Giro 3 - ATM me funksion depozitim cash	
II.	Terminale POS (Point of Sale) prej të cilave: 1 - terminale POS me funksion tërheqje cash 2 - terminale EFTPOS	
III.	Terminale virtuale POS për përdorimin e kartelave	
IV.	Terminale për përdorimin e parasë elektronike	

Rubrika	Përshkrimi i Llogarive	Numri i llogarive në :						numri nga totali që përdorin :		
		EUR	USD	CHF	GBP	Valuta tjera	TOTAL	E-banking	Debitim Direkt	Urdhëresën periodike
I.	Llogaritë e klientëve	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	1 - llogari të rezidentëve	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	a - individuale		0	0	0	0	0		0	
	b - afariste		0	0	0	0	0		0	
	2 - llogari të jorezidentëve	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	a - individuale		0	0	0	0	0		0	
	b - afariste		0	0	0	0	0		0	

Forma 13 - C. Transaksionet sipas tipave të terminaleve

Rubrika	Përshkrimi i transaksionet sipas tipeve të terminaleve	Numër	Vlera
I	Transaksione në терминаlet e instaluara nga banka raportuese, me kartela të lëshuara nga banka raportuese	0	0
	prej të cilave:		
	1 - ATM tërheqje cash		
	2 - ATM depozitime cash		
	3 - Kredit transfere nëpërmjet ATM-ve		
	4 - Tërheqje cash në terminale POS		
II	Transaksione në терминаlet e instaluara në vend nga bankat tjera, me kartela të lëshuara nga banka raportuese	0	0
	prej të cilave:		
	1 - ATM tërheqje cash		
	2 - ATM depozitime		
	3 - Kredit transfere nëpërmjet ATM-ve		
	4 - Tërheqje cash në terminale POS		
III	Transaksione në терминаlet e instaluara jashtë vendit, me kartela të lëshuara nga banka raportuese	0	0
	prej të cilave:		
	1 - ATM tërheqje cash		
	2 - ATM depozitime		
	3 - Kredit transfere nëpërmjet ATM-ve		
	4 - Tërheqje cash në terminale POS		
IV	Transaksione në терминаlet e instaluara nga banka raportuese, me kartela të lëshuara nga banka të vendit	0	0
	prej të cilave:		
	1 - ATM tërheqje cash		
	2 - ATM depozitime	0	0
	3 - Kredit transfere nëpërmjet ATM-ve	0	0
	4 - Tërheqje cash në terminale POS	0	0
V	Transaksione në терминаlet e instaluara nga banka raportuese, me kartela të lëshuara nga banka jashtë vendit	0	0
	prej të cilave:		
	1 - ATM tërheqje cash		
	2 - ATM depozitime	0	0
	3 - Kredit transfere nëpërmjet ATM-ve	0	0
	4 - Tërheqje cash në terminale POS	0	0
VI	Numri total i transaksioneve në терминаlet e bankës raportuese (I + IV +V)	0	0
	prej të cilave:		
	1 - ATM tërheqje cash	0	0
	2 - ATM depozitime	0	0
	3 - Kredit transfere nëpërmjet ATM-ve	0	0
	4 - Tërheqje cash në terminale POS	0	0
	5 - Pagesa me kartela në terminale POS	0	0

<u>Komuna</u>	<u>Terminalet ATM</u>		<u>Terminalet POS</u>	
	<u>Aktiv</u>	<u>*Pasiv</u>	<u>Aktiv</u>	<u>Pasiv*</u>
Prishtinë				
Podujevë				
Obiliq				
Novobërdë				
Lipjan				
Graçanicë				
Gllgovc				
Fushë Kosovë				
Mitrovicë				
Skënderaj				
Vushtrri				
Zubin Potok				
Zveçan				
Leposaviq				
Pejë				
Gjakovë				
Deçan				
Istog				
Klinë				
Junik				
Prizren				
Dragash				
Malishevë				
Suharekë				
Rahovec				
Mamushë				
Ferizaj				
Shtime				
Kaçanik				
Hani i Elezit				
Shtërpcë				
Gjilan				
Kamenicë				
Klllokot				
Partesh				
Viti				
Ranillug				

**Një terminal konsiderohet pasiv në qoftë se ai nuk është përdorur për të kryer së paku një transaksion në periudhën e fundit raportuese*

Kartelat sipas gjinisë / grup-moshës së mbajtësit	Numër					Totali
	18-25	26-35	36-45	46-55	55+	
1- femra						
2- meshkuj						
Totali	-	-	-	-	-	-

Forma 13 - H. Numri i kartelave aktive

TM	Kartela të shpërndara					Kartela Aktive*					Përqindja e kartelave aktive**				
	Debiti	Kredit	e-money	Tjera	TOTALI	Debiti	Kredit	e-money	Tjera	TOTALI	Debiti	Kredit	e-money	Tjera	TOTALI
I					0					0					
II					0					0					
III					0					0					
IV					0					0					

* Një kartelë konsiderohet aktive në qoftë se ajo është përdorur për të kryer të paktën një transaksion gjatë periudhës raportuese

** Përqindja e kartelave aktive ndaj numrit të përgjithshëm të kartelave të lëshuara

